

Statistikat e Bujqësisë 2019

Tiranë, më 19 Qershor 2020: Në vitin 2019, prodhimi i perimeve është 1.258,012 tonë, duke shënuar rritje vjetore me 7,87 %, krahasuar me vitin 2018. Niveli më i lartë i prodhimit të perimeve është në qarqet Fier me 484.366 tonë, Tiranë me 128.666 tonë dhe Berat me 126.555 tonë.


Prodhimi i drithërave në vitin 2019 është 666.064 tonë, duke shënuar rënie me 1,79 %, në krahasim me një vit më parë. Niveli më i lartë i prodhimit të drithërave u arrit në qarkun e Fierit me 171.480 tonë, pasuar nga qarqet Elbasan me 97.454 tonë dhe Korçë me 73.776 tonë.

Në vitin 2019, prodhimi i patates është 260.661 tonë, duke shënuar rritje me 2,40 %, në krahasim me vitin 2018. Qarqet që kanë nivelin më të lartë të prodhimit janë, Korça me 66.016 tonë, Fieri me 50.158 tonë dhe Elbasani me 26.636 tonë.

Tab.1 Prodhimi bujqësor (mijë tonë)


Prodhimi bujqësor	2015	2016	2017	2018	2019
Bimët e arave					
Drithëra	695,5	698,4	701,7	678,2	666,1
Perime	1.030,0	1.129,1	1.151,9	1.166,3	1.258,0
Patate	245,0	238,3	249,8	254,5	260,7
Fasule	28,0	25,0	21,2	24,5	24,8
Bimë industriale	-	-	32,7	30,8	33,7
Bimë medicinale	10,8	10,6	12,8	12,5	12,9
Foragjere	6.000,0	6.144,0	6.688,6	7.050,1	7.115,2
Drufrutorët					
Pemë frutore	245,0	261,0	262,6	274,3	272,6
Ullinj	96,0	99,0	107,8	117,6	98,3
Agrume	30,0	40,0	41,0	45,5	46,9
Rrush	205,0	205,1	202,9	184,8	189,9

Fig. 1 Prodhimi i drithërave, perimeve dhe patates (mijë tonë)




Prodhimi i perimeve në seri kohore ka një tendencë në rritje, ku perimet e njoma kanë rritjen më të dukshme, për shkak të prodhimit në serra, pasuar nga bostanoret dhe perimet e thata.

Fig. 2 Prodhimi i perimeve, seri kohore (mijë tonë)



Perimet e njoma përfaqësojnë 66,19 % të perimeve gjithsej ndjekur nga bostanoret me 23,88 % dhe perimet e thata me 9,93 %.

Fig. 3 Struktura e prodhimit të perimeve, 2019




Në vitin 2019, u prodhuan 832.732 tonë perime të njoma duke shënuar rritje 7,91 %, krahasuar me vitin 2018. Në grupin e perimeve të njoma, kulturat përfaqësuese, janë domatja me 35,99 %, kastravec 15,21 % dhe speci 10,21 %. Në perimet e thata, qepa e thatë përfaqëson 87,59 % ndaj prodhimit gjithsej, ndërsa në prodhimin e bostanoreve shalqini përfaqëson 86,45 % të prodhimit.

Prodhimi i perimeve në serra përfaqëson 21,35 % të prodhimit gjithsej të perimeve. Prodhimi i perimeve në serra në vitin 2019, pësoi rritje vjetore me 5,56 %, krahasuar me një vit më parë.

Prodhimi i drufrutorëve përfaqësohet nga prodhimi i pemëve frutore, ullinjve, agrumeve dhe rrushit.

Fig. 4 Prodhimi i drufrutorëve në seri kohore (mijë tonë)




Prodhimi i pemëve frutore në vitin 2019 është 272.643 tonë, duke pësuar rënie me 0,62 %, krahasuar me një vit më parë. Niveli më i lartë i prodhimit u arrit në qarkun e Korçës me 83.555 tonë pasuar nga qarqet Elbasan me 37.027 tonë dhe Fier me 32.634 tonë.

Në vitin 2019 u prodhuan 98.313 tonë ullinj, duke pësuar rënie me 16,38 %, krahasuar me një vit më parë. Niveli më i lartë i prodhimit të ullirit u arrit në qarkun Fier me 31.363 tonë pasuar nga qarqet Vlorë me 18.364 tonë dhe Elbasan me 17.561 tonë. Ullinjtë për vaj përfaqësojnë 88,91 % të prodhimit total të ullirit dhe ullinjtë për tavolinë 11,09 %.

Në grupin e faroreve peshë kryesore e zënë molla 84,83 %, ndërsa në grupin e bërthamoreve peshën më të madhe e zënë kumbullat 47,94 %, pasuar nga pjeshkët 23,29 % dhe qershitë 23,05 %.

Në grupin e subtropikale peshë kryesore e zënë fiqtë 51,99 % pasuar nga shegët 14,87 %, ndërsa në grupin e arroveve peshë kryesore e zënë arrat 43,65 %, pasuar nga geshtenjat 41,17 %.

Fig. 5 Struktura e prodhimit të pemëve frutore, 2019



Prodhimi i agrumeve në vitin 2019 është 46.882 tonë duke shënuar rritje me 3,04 %, krahasuar me një vit më parë. Niveli më i lartë i prodhimit të agrumeve u arrit në qarkun e Vlorës 31.774 tonë.

Në vitin 2019 prodhimi i rrushit është 189.904 tonë duke shënuar rritje me 2,67 %, krahasuar me një vit më parë. Në prodhimin total të rrushit 40,05 % përfaqësohet nga prodhimi i rrushit nga pjergullat dhe 59,95 % nga prodhimi i rrushit nga vreshtat.

Metodologjia

Statistikat e bujqësisë për vitin 2019 mbështeten në informacionin administrativ, të mbledhura nga Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural. Baza ligjore për mbledhjen e statistikave bujqësore dhe blegtorale është Programi i Statistikave Zyrtare 2017-2021, duke zbatuar klasifikimet dhe përkufizimet sipas rregulloreve përkatëse të BE-së.

Informacioni mbledhet në terren nga specialistët e ekstensionit në të gjithë vendin. Këta specialistë mbledhin të dhëna drejtpërdrejt nga fermerët. Prodhimi bujqësor është sinonim me prodhimin e vjelë dhe përfshin sasi të shitura, konsumin direkt në familjet fermere, humbjet dhe mbetjet në fermë, si dhe humbjet gjatë transportit, ruajtjes dhe paketimit.

Statistikat e bimëve i referohen të dhënave vjetore si: sipërfaqe e kultivuar, sipërfaqe prodhuese për drufrutorët, prodhim dhe rendiment.

Të dhënat për rendimentin e prodhimeve grumbullohen nga fermat më përfaqësuese në nivel komune. Të dhënat e grumbulluara dërgohen në Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, ku specialistët e prodhimit bimor bëjnë vlerësime duke krahasuar të dhënat e grumbulluara nga terreni me të dhënat e fermave në vite.

Përkufizime

Njësia Ekonomike Bujqësore (NjEB) - është njësi e vetme, teknike ekonomike, e përcaktuar në një drejtim unik, nga terreni dhe pse në parcela jo të vazhdueshme, në të cilën realizohet prodhimi bujqësor dhe blegtoral që drejtohet nga një person i vetëm ose grup personash, për realizimin e veprimtarive bujqësore.

Tokë e punueshme

Toka e punueshme është toka arë e pluguar ose e lëruar rregullisht, sipas një sistemi të qarkullimit bimor. Qarkullimi bimor është praktika e rritjes alternative të kulturave bimore njëvjeçare në një fushë specifike sipas një modeli ose renditje të planifikuar në vitet prodhuese pasuese. Normalisht, kulturat njëvjeçare ndryshojnë çdo vit, por ato mund të jenë edhe shumëvjeçare (jonxhë). Për të dalluar tokën e punueshme nga toka e zënë me kultura drufrutore ose kullota e livadhe përdoret një prag prej pesë vjetësh.

Sipërfaqja e kultivuar me bimë arash, është sipërfaqja e mbjellë me bimë arash në vitin bujqësor të dhënë. Këtu bëhet fjalë për sipërfaqe me kultura kryesore (të para). Këto kultura kryesore, normalisht kanë vlerë ekonomike më të lartë se kulturat e tjera dhe zënë tokën në pjesën më të madhe të vitit.

Kulturat kryesore janë drithrat e bukës, kulturat e pranverës misri kokërr, patatja, fasulja, bimët industriale, foragjeret shumëvjeçare, etj.

Drufrutorët

Drufrutorët përfaqësohen nga pemët frutore (frutat farore, bërthamore, subtropikale, arvore e tjera), ullinjë, agrumet, vreshtat dhe pjergullat.

Viti i prodhimit

Me vit prodhimi nënkuptojmë vitin kalendarik në të cilin fillon vjelja e prodhimit.

Sipërfaqja e kultivuar

Sipërfaqja e kultivuar korrespondon me sipërfaqen totale të mbjellë për prodhimin e një kulture bujqësore, specifike gjatë një viti kalendarik të dhënë. Nga kjo sipërfaqe përjashtohen sipërfaqet e dëmtuara nga dëmtues natyror (përmbytjet, zjarre etj). Sipërfaqja e kultivuar përfshin sipërfaqet e mbjella me kulturave të para dhe të dyta. Sipërfaqja e perimeve gjithsej përfaqësohet nga sipërfaqja e perimeve të njoma, të thata dhe bostanoreve.

Sipërfaqja prodhuese

Sipërfaqja prodhuese e drufrutorëve është sipërfaqja potenciale prodhuese. Përjashtohen sipërfaqet e pemëtoreve të reja, blloqet e drufrutorëve extensive dhe të degraduara.

Klasifikimi

Klasifikimi i bimëve të arave bëhet sipas grup kulturash (drithëra, perime, bimë industriale, foragjere, farëra vajore, patate, fasule) në fushë të hapur dhe serra, kulturë e parë dhe e dytë.

Klasifikimi i drufrutorëve bëhet sipas grupeve kryesore: pemët frutore, ullinj, agrume, vreshta dhe pjergulla për numrin e pemëve gjithsej, pemët në prodhim, prodhimin dhe rendimentin.